



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 49 datë 22.11.2023

**“PËR MIRATIMIN E PRANIMIT TE DHURIMIT TË IMPIANTIT
FOTOVOLTAIK I CILI DO TË VENDOSSET PRANË SHKOLLËS” KOL
IDROMENO” DHE DHËNIEN E AUTORIZIMIT PËR NËNSHKRIMIN E
MARRËVESHJES SË BASHKEPUNIMIT NDËRMJET SUBJEKTIT
“EUROELEKTRA” SHPK DHE PËRFITUESIT BASHKIA SHKODËR”**

Keshilli Bashkiak Shkoder, në mbledhjen e tij të datës 22.11.2023, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 9 pika 1.2 të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar; Ligjit nr 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë së rinovueshme; Ligjit nr 107/2014 ”Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” të ndryshuar; VKM nr.408, datë 13.05.2015 ”Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të territorit“ të ndryshuar; VKM Nr.421, datë 02.06.2010 “Për miratimin e listës Përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Shkodër, të Qarkut të Shkodrës” të ndryshuar; Vertetim Hipotekor nr.489 dt.24.12.2013; Udhëzimit nr 30, datë 27.12.2011 “ Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik” i ndryshuar si dhe relacionit të administratës së bashkisë Shkodër:

V E N D O S I:

1. Të miratojë pranimin e dhurimit të impiantit fotovoltaik i cili do të vendoset pranë shkollës “ Kol Idromeno” dhe dhëniën e autorizimit për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet subjektit “Eurolektra” shpk dhe përfituesit bashkia Shkodër”
2. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

KRYETAR

Oltion LULI



Sekretari i Këshillit Bashkiak

Denis Lesha

Miratuar me 41 vota

Vota Pro 41

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 23.11.2023